

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reuters: Demokratët do të hetojnë marrëveshjet fitimprurëse të biznesit të familjes Trump nëse fitojnë S enatin
ADRESA	https://versus.al/bota/reuters-demokratet-do-te-hetojne-marreveshjet-fitimprurese-te-biznesit-te-f-i47312
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:36:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4779a9d2b0a6c0ed2c2dcbc36ca51ccef819c3b976316a5ce8d22fdd1a47f8f7
TEKSTI	16346dd166c7f96bc4cf3b6a842910f78d83a7abe08b118d4d52cf8aa6c8a12b
PAMJA	5a2c637fee9baad94b3443e0e5c1426d0cc161d781fce273a858f8b6f6a4ee0e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	86951fc2902434912a414d30efc614ddbcf7897bb9ff1f9a88293115ff7dcaa4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/86951fc2902434912a414d30efc614ddbcf7897bb9ff1f9a88293115ff7dcaa4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



AKTUALITET

41 kg kokainë si "mall pa zot"! SPAK në kërkim të "pronarit" të drogës së fshehur tek konteneri me mish pule i AMG Food

28 Shtator 2026, 16:30

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[BOTA](#) / 28 Shtator 2026, 18:32

Reuters: Demokratët do të hetojnë marrëveshjet fitimprurëse të biznesit të familjes Trump nëse fitojnë Senatin

Hetimet mund të dominojnë gjysmën e dytë të mandatit të Trumpit, pas dy vitesh aktiviteteve biznesi gjatë të cilave familja Trump u zgjerua në fusha si kriptovalutat, dronët, inteligjenca artificiale dhe tregjet e parashikimeve





Donatorët korporativë që kanë kontribuar për eventet e Presidentit amerikan Donald Trump, si dhe pjesëmarrësit në marrëveshje biznesi të ndërmjetësuar nga anëtarët e familjes Trump, pritet të jenë ndër objektivat e para të hetimeve nëse demokratët marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve ose të Senatit në zgjedhjet e ndërmjetme të nëntorit; këtë e kanë konfirmuar për Reuters ditët e fundit disa punonjës të Kongresit, ligjvënës dhe avokatë.

Reuters shkruan se, kontrolli mbi cilëndo prej dhomave të Kongresit do t'u jepte demokratëve autoritetin për të lëshuar urdhra ligjorë për dorëzimin e dokumenteve (subpoena) dhe fondet për të shtuar stafin hetimor, duke u mundësuar atyre të nisnin hetime që në muajin shkurt dhe potencialisht të shkaktojnë betejë të gjata ligjore që do ta vendosnin perandorinë e biznesit të familjes Trump në qendër të vëmendjes.

Hetimet mund të dominojnë gjysmën e dytë të mandatit të Trumpit, pas dy vitesh aktiviteteve biznesi gjatë të cilave familja Trump u zgjerua në fusha si kriptovalutat, dronët, inteligjenca artificiale dhe tregjet e parashikimeve, ndërsa pasuria personale e presidentit u rrit me rreth 2.2 miliardë dollarë.

"Nuk mendoj se demokratët do të kenë durim. Ata do të presin dokumente mjaft shpejt. Nuk do të mund të luhet më loja e vjetër e zvarritjes së kohës," tha Ashley Callen, avokate në firmën ligjore Jenner & Block, e cila më parë ka shërbyer si këshilltare ligjore kryesore për Kryetarin republikan të Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson.

Lideri demokrat i Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së, Hakeem Jeffries nga Nju Jorku, u tha gazetarëve më 17 shtator: "Ne do t'i mbajmë përgjegjësi keqbërësit, duke filluar që në ditën e parë."

Administrata Trump e kritikoi mundësinë e këtyre hetimeve. "Demokratët nuk kanë asnjë agjendë për të përmirësuar jetën e popullit amerikan, por vetëm plane për të penguar dhe për të vënë në shënjestër pa baza agjendën e arsyeshme të Presidentit Trump," tha zëdhënësjja e Shtëpisë së Bardhë, Olivia Wales, në një deklaratë me email dërguar Reuters-it.

Korporatat janë objektiva të përshatshme për hetime sepse, ndryshe nga Shtëpia e Bardhë, ato nuk mund të pretendojnë se aktivitetet e tyre mbrohen nga privilegji ekzekutiv.

Interes të veçantë paraqesin kompanitë e kriptovalutave të lidhura me Trumpin dhe firma e kapitalit sipërmarrës e Donald Trump Jr., "1789 Capital", sipas përfaqësuesit demokrat Jamie Raskin nga Maryland dhe senatorit demokrat Richard Blumenthal nga Connecticut, megjithëse të dy theksuan se ende nuk ka një listë përfundimtare të objektivave.

Kompanitë me lidhje me Trumpin dhe familjen e tij po kryejnë përgatitje urgjente, duke përfshirë punësimin e avokatëve për auditime të brendshme dhe firma komunikimi në kriza për kontakte me publikun, sipas intervistave me këshilltarë të korporatave, specialistë të menaxhimit të krizave, staf të kongresit dhe ligjvënës.

Senatori demokrat Sheldon Whitehouse i Rhode Island zbuloi një raport të enjten, duke thënë se kompanitë e naftës dhe gazit fituan lehtësime tatimore, subvencione dhe rregullore më të lirshme mjedisore pasi Trump u kërkoi atyre 1 miliardë dollarë donacione gjatë fushatës së tij presidenciale të vitit 2024, duke shtuar një tjetër rrugë të mundshme për hetim.

FOKUSI TE FAMILJA TRUMP

Adam Schiff, senatori demokrat nga Kalifornia, u dërgoi një paralajmërim kompanive që të mos fshijnë asnjë regjistrim që lidhet me transaksionet me Trump-in dhe administratën e tij.

"Ne mund t'ia vështirësojmë shumë jetën administratës nëse abuzoni me kërkesat legjitime të Kongresit për mbikëqyrje," tha Schiff në një intervistë, duke iu referuar kompetencave të Kongresit mbi financimin e agjencive.

Ndër transaksionet ku është përqendruar Schiff është shitja e propozuar e një pjese të Parkut Kombëtar Yosemite të një zhvillues privat që ka lidhje me komitetet e fushatës republikane. "Në këtë administratë gjithçka është në shitje, përfshirë thesaret tona më të çmuara si Yosemite," tha ai.

Megjithatë, objektivi kryesor i demokratëve duket se është familja Trump – veçanërisht Donald Jr., i cili ka lidhur një sërë marrëveshjesh biznesi që kur babai i tij mori detyrën në nëntor të vitit 2024. "Familja e parë ka fituar shuma të mëdha parash," tha Schiff.

Dhëndri i Trump-it, Jared Kushner, "është një drejtues korporate me të cilin patjetër që do të duhet të flasim," tha Raskin, i cili mund të bëhet kryetar i Komisionit të fuqishëm Gjyqësor nëse demokratët marrin kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve.

Ai tha se Kushner nuk u është përgjigjur dy letrave që kërkonin informacion mbi marrëveshjet e firmës së tij të investimeve private, "Affinity Partners", me "monarkitë e naftës dhe qeveritë" e Lindjes së Mesme, ndërkohë që ai përfaqëson gjithashtu Shtetet e Bashkuara në negociatat diplomatike.

Raskin përmendi marrëveshjet që Kushner siguroi me Arabinë Saudite, Katarin dhe Emiratet e Bashkuara Arabe ndërsa shërbente si i dërguar presidencial. "Ky është një konflikt interesi skandaloz," tha ai.

Kushner është i dërguari i posaçëm i SHBA-së për paqen, por jo punonjës qeveritar.

Punonjësit federalë u nënshtrohen rregullave që i ndalojnë ata të përfshihen në aktivitete që mund t'u sjellin përfitime financiare.

Chad Mizelle, avokat i Kushner-it, tha në një deklaratë se akuzat kundër tij janë të pavërteta. "Dhe deri më sot, askush — madje as kritikët e Jared-it — nuk ka identifikuar qoftë edhe një rregull apo normë të zbatueshme që ai të ketë shkelur," tha Mizelle.

Raskin veçoi gjithashtu një kredi prej 620 milionë dollarësh nga Pentagoni për kompaninë fillestare (startup) të metaleve të rralla "Vulcan Elements", e cila u njoftua rreth tre muaj pas një investimi noa fondi i kanilitit sipërmarrës "1789" i Don Jr.

"Ai duket se ka një aftësi parashikuese për të ditur saktësisht se kush do t'i marrë kontratat qeveritare dhe kush do të përfitojë nga trajtimi favorizues rregullator në administratën Trump," tha Raskin.

Në një deklaratë për Reuters, një zëdhënës i "Vulcan" tha se kompania "nuk u kërkoi dhe as nuk u bëri thirrje investitorëve të saj që të lehtësonin marrjen e kredisë nga Pentagoni" dhe se do të vazhdojë të bashkëpunonte me Kongresin në "mirëbesim".

"1789 Capital" angazhoi firmën prestigjioze ligjore "Quinn Emanuel" për të trajtuar hetimet e Kongresit dhe tashmë po sinjalizon synimin e saj për t'iu kundërvënë kërkesave të demokratëve për informacion.

"1789 Capital e mirëpret mbikëqyrjen legjitime të Kongresit," thuhej në një përgjigje drejtuar Kongresit më 9 shtator, "por nuk ka ndërmend të bëhet peng i lojërave politike."

Në një deklaratë për Reuters, një zëdhënës i "1789" tha se "Ligjvënësi Raskin nuk ka ofruar asnjë provë për shkelje, vetëm akuza të motivuara politikisht," duke shtuar se letra e tij tregonte një "mungesë shqetësuese të njohurive financiare."

RREZIQË PËR DREJTUESIT E KOMPANIVE

Senatori republikan Kevin Cramer nga Dakota e Veriut e hodhi poshtë nevojën për hetime të tilla dhe i tha Reuters-it se demokratët mund të përballen me reagim negativ nga votuesit nëse "fiksohen dhe përqendrohen tepër te Donald Trump, jeta e tij personale dhe bizneset e tij, në vend që të merren me çështjet që kanë rëndësi për popullin amerikan."

Megjithatë, disa republikanë mund t'u bashkohen përpjekjeve të demokratëve. Senatori republikan John Curtis nga Utah, i cili sapo ka nisur mandatin, bëri thirrje që Don Jr. të hetohet për lejin e një oligarku rus që të paguante për festat e dasmës së tij në Bahamas.

Kompanitë do të duhet të vendosin nëse do t'u përgjigjen shpejt hetimeve – gjë që mund të shkaktojë zemërimin e Trumpit – apo jo, thanë disa avokatë. Dështimi për të bashkëpunuar me Kongresin mund të sjellë rreziqe ligjore për drejtuesit dhe reagime negative të mundshme nga konsumatorët.

"Ekziston gjithmonë rreziku për reputacionin në çdo hetim të Kongresit," tha Kevin Edgar, partner ligjor në firmën "BakerHostetler" dhe ish-ndihmës në Kongres.

Një avokat, i cili kërkoi anonimitet për të mbrojtur klientët, tha se një rezultat ideal mund të ishte në fakt padia nga Shtëpia e Bardhë për t'i ndaluar ata të prodhojnë informacione mbi bazën e privilegjit ekzekutiv. "Kjo u jep atyre mundësinë të thonë: Mami dhe babi më tregoni çfarë të bëj", tha avokati.

Disa kompani tashmë po i referonin kërkesat për informacion Shtëpisë së Bardhë.

Në një letër të 1 korrikut të pa raportuar më parë, të parë nga Reuters, kontraktori i sallës së vallëzimit Clark Construction iu përgjigj një kërkesë në lidhje me "kostot e fryrjes" nga Blumenthal duke thënë se kushtet e marrëveshjes kërkonin që të gjitha informacionet të vinin nga Shtëpia e Bardhë.

Blumenthal, i cili është në radhë për të kryesuar një panel hetimor, i tha Reuters: "Ne do të përdorim fuqinë tonë të thirrjes në gjyq, absolutisht", nëse demokratët fitojnë kontrollin e Senatit në nëntor.

Poll



BOTA

[E premtoi vetë para zgjedhjeve, parlamenti hungarez heq imunitetin e kryeministrit Magyar](#)

28 Shtator 2026, 14:08

^ekstrakti^




BOTA

[Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK, Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën: Aktgjykim i padrejtë](#)

28 Shtator 2026, 13:10

^ekstrakti^





BOTA

[U dorëhoq si president, Vuçiç e lë porosi: Mos hiqni dorë nga Kosova](#)

27 Shtator 2026, 20:29

^ekstrakti^



BOTA

[Serbia 'u ndez' nga protestat, Aleksandër Vuçiç dorëhiqet si president! Mban fjalimin e fundit: E di që kam bërë gabime](#)

27 Shtator 2026, 20:10

^ekstrakti^



BOTA

[Referendumi për neutralitetin në Zvicër, zvicërianët rrëzojnë propozimet për rregulla më të rrepta](#)

27 Shtator 2026, 18:44

^ekstrakti^



BOTA

[Paralajmërimi i frikshëm i Bill Gates: Inteligjenca Artificiale mund të vr*së 1 miliard njerëz](#)

27 Shtator 2026, 17:49

^ekstrakti^



BOTA

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.